

Në kuadër të bashkëpunimit mes Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Agjencisë Suedeze të Kontigjencave Civile (MSB), ka nisur implementimin projekti “REAGO - Rritja e Aftësisë për Gatishmëri dhe Organizim në Komunitet”, që do të zbatohet përgjatë viteve 2025-2028

Takimi i parë prezantues u zhvillua në nëntor 2025, ku pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues të institucioneve të sistemit të Mbrojtjes Civile si dhe palë të interesuara.

Projekti i financuar nga SIDA, konsiston në:

- Bashkëpunim dypalësh ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (NCPA) në Shqipëri dhe Agjencisë Suedeze të Mbrojtjes Civile dhe Rimekembjes (MCF)

Qëllimi i përgjithshëm i projektit:

Përmirësimi i koherencës dhe konsistencës së gatishmërisë ndaj fatkeqësive në Shqipëri dhe përafrimi i saj me praktikën e BE-së.

Qëllimi specifik i projektit:

Forcimi i kapaciteteve për gatishmërinë ndaj fatkeqësive në Shqipëri nëpërmjet ndërgjegjësimit të publikut, edukimit dhe zhvillimit të koordinimit ndër-institucional në fushën e mbrojtjes civile si dhe reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë.

Komponentët e projektit:

1. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për rreziqet nga fatkeqësitë dhe mundësitë për gatishmërinë për emergjencat shtëpiake. Ky komponent do të fokusohet në krijimin e një ombrelle për ndërgjegjësimin e publikut dhe veprimet e komunikimit të veprimeve në Shqipëri, vendosjen e standardeve dhe krijimin e mjeteve për planifikimin, zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e efekteve të nismave të ndryshme publike ndërgjegjësuere në vend.

2. Krijimi i urave të bashkëpunimit dhe shembja e hendekut ndërmjet autoriteteve të Mbrojtjes Civile dhe sistemit arsimor/akademik. Qëllimi kryesor i këtij komponenti do të jetë kultivimi i bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet institucioneve të mbrojtjes civile dhe akademisë. Nga njëra anë, promovimi i integritetit të temave të mbrojtjes civile në sistemin arsimor, kurrikulën shkollore; dhe, nga ana tjetër, mundësimin e politikëbërjes e bazuar në kërkime shkencore në fushën e MC dhe DRM.

3. Përmirësimi i koordinimit ndër-institucional. Efektiviteti i përpjekjeve për gatishmëri ndaj fatkeqësive është shumë i ndërlidhur me koherencën dhe konsistencën e veprimeve të ndërmarra në të gjithë vendin. Kjo mund të arrihet përmes zgjerimit të koordinimit të aktorëve të ndryshëm aktivë në këtë fushë, që është pjesë thelbësore e misionit të AKMC-së.

Disa nga aktivitetet sipas komponentëve:

Komponenti 1. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut për rreziqet nga fatkeqësitë dhe masat e gatishmërisë së familjeve për emergjencë të mundshme.

- Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Ndërgjegjësimin Publik dhe Komunikimin e Krizave në përputhshje me Strategjinë Kombëtare DRM dhe standardet e BE-së.
 - Hartimi i një kuadri/harte veprimesh, për zbatimin e strategjisë kombëtare të NP.
 - Ndërgjegjësimi i publikut në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor.
 - Zhvillimi i trajnimeve për bashkitë
 - Ngritja e kapaciteteve të aktorëve relevantë (p.sh. bashkitë) për përfshirjen e perspektivave gjinore, mjedisore dhe të drejtave të njeriut etj.
 - Fushata pilot për NP në disa bashki, për të përmirësuar gatishmërinë shtëpiake.
- Koordinimi i zgjeruar ndërinstitucional, etj.